STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 7 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE BANKA KRYESORE DHE OFRUES TE HIPOTEKAVE PO JAPIN NDIHME PER HUAMARRESIT E HIPOTEKAVE PAS SENDIT (SANDY)

Ndihma përfshin mos-rimarrje ose asnjë kamatë vonesë për 90 ditë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se disa banka kryesore të çertifikuara nga shteti dhe ofrues të hipotekave kanë pranuar që të japin ndihmë për huamarrësit e hipotekave për shtëpitë në zonat e prekura nga Stuhia Sendi (Sandy), duke përfshirë në shumë raste mos-rimarrje dhe asnjë kamatë vonesë për 90 ditë.

Bankat e çertifikuara nga shteti që po japin përpjekje për ndihmë me huatë përfshijnë Apple Savings Bank, Dime Savings Bank of Williamsburg, Emigrant Savings Bank, M&T Bank, New York Community Bank, Ridgewood Savings Bank, Hanover Community Bank, mes të tjerave. Ofruesit e hipotekave të rregjistruar në shtet që po japin përpjekje për ndihmë me huatë përfshijnë Citi Mortgage, Homeward Residential, Ocwen Loan Servicing, Nationstar, si dhe të tjerë.

“Mijëra shtetas të Nju Jorkut humbën gjithshka, ndërsa të tjerë janë në vështirësi pa energji elektrike dhe me aftësi të kufizuar për të udhëtuar ose komunikuar. Si rezultat, disa njerëz mund të kenë vonesa në pagesat e hipotekave ose mund të pësojnë tarifa dhe pagesa të tjera bankare. Jam krenar të them se bankat kryesore të çertifikuara në Shtetin e Nju Jorkut dhe ofruesit e rregjistruar të hipotekave kanë pranuar që të heqin tarifat dhe pagesat, në mënyrë që huamarrësit, të cilët tashmë janë duke u përballur me vështirësi dhe shpenzimet e rimëkëmbjes, të mos kenë këtë kosto shtesë. I bëj thirrje çdo banke të çertifikuar në shtet dhe ofruesve të shërbimeve që nuk kanë dhënë ende programe të ndihmës për huamarrësit që të ndjekin këtë shembull,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo).

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare, tha, “Shumë njerëz kanë humbur tashmë shtëpitë e tyre ose janë duke u përballur me riparime të vështira. Nuk dëshirojmë t’i shtojmë këtij problemi që njerëzit të humbasin shtëpitë e tyre ose të krijojnë probleme financiare sepse nuk mund të bëjnë pagesa të hipotekave në kohë për shkak të stuhisë. Do të vazhdojmë të punojmë me bankat dhe ofruesit e hipotekave për të mbrojtur ata që po vuajnë nga Sendi (Sandy).”

Hollësitë mund të ndryshojnë nga institucioni në institucion dhe huamarrësit duhet të kontaktojnë bankën ose ofruesin e hipotekës së tyre individuale për veçoritë. Në përgjithësi, bankat dhe ofruesit e hipotekave janë duke punuar me huamarrësit që mund të jenë dëmtuar si rezultat i Stuhisë Sendi (Sandy) dhe po japin llojet e ndryshme të ndihmës:

- Shtyrje për 90 ditë të rimarrjeve dhe dëbimeve.
- Heqje për 90 ditë të kamatë vonesave për pagesat e hipotekave, përfshirë pagesat në internet.
- Në disa raste, zgjatje të afatit të pagesës së hipotekës për 90 ditë ose më shumë kur huamarrësi është prekur nga stuhia dhe kërkon ndihmë.
- Heqjen e interesit kur një veprim rifinancimi është përfunduar, por nuk është financuar.
- Për huamarrësit në një ndryshim gjyqi, pagesat e vonuara nuk do të ndikojnë negativisht në gjendjen e tillë ose nuk do të parandalojnë që huamarrësit të marrin ndryshime të përhershme të hipotekës.
- Bankat dhe ofruesit e shërbimeve nuk do të njoftojnë zyrat e kredisë nëse huamarrësit bëjnë pagesa të vonuara.

Kryeinspektori Loski (Lawsky) gjithashtu u bëri thirrje bankave dhe ofruesve të shërbimeve që të rivlerësojnë nevojat e tanishme për kredi të komuniteteve për të ndihmuar në përmbushjen e atyre nevojave duke dhënë hua të duhura. Ata gjithashtu duhet të konsiderojnë një ristrukturim të kujdesshëm të detyrimeve të borxhit të një huamarrësi të prekur, duke ndryshuar ose rregulluar kushtet e pagesës.

“Bankat dhe ofruesit vendorë të hipotekave mund të luajnë një rol kryesor në ndihmën që komunitetet tona të rimëkëmben, ashtu siç kanë luajtur një rol kryesor në zhvillimin e tyre përpara stuhisë,” tha Kryeinspektori Loski (Lawsky). Kryeinspektori Benxhëmin Loski (Benjamin Lawsky) gjithashtu u kujtoi ofruesve të hipotekave se si rezultat i urdhërit që ndalon dhënien fund, anullimin ose mos-rinovimin e policave të sigurimit të pronarëve të shtëpive për 30 ditë duke filluar më 26 tetor, ofruesit e shërbimeve nuk mund të vendosin me detyrim sigurim mbi ndonjë pronar shtëpie që kishte sigurim në fuqi në atë datë. Meqë sigurimi i pronarëve të shtëpive do të mbetet në fuqi, asnjë sigurim i vendosur me detyrim nuk është i nevojshëm për të mbrojtur interesat e huadhënësve.

Normalisht, ofruesit e shërbimeve kanë të drejtë të blejnë atë që njihet si sigurim i vendosur me detyrim nëse një pronar shtëpie nuk mban sigurimin e kërkuar nga hipoteka. Kjo ndodh shpesh kur pronarët e shtëpive kanë vonesa në pagesat e hipotekës. Sigurimi i vendosur me detyrim është zakonisht shumë më i shtrenjtë sesa mbulimi i blerë nga një pronar shtëpie, megjithatë shpesh siguron mjaft më pak mbrojtje për pronarin e shtëpisë.

Institucioneve financiare që kërkojnë udhëzime shtesë për të ndihmuar blerësit e prekur nga ndikimi i Stuhisë Sendi (Sandy) u bëhet thirrje të kontaktojnë zyrën e Departamentit në Albani në 518-473-6160.

Sara Ludvig (Sarah Ludwig), Bashkë-Drejtoreshë e NEDAP-it, një organizatë e drejtësisë ekonomike me qendër në Qytetin e Nju Jorkut, tha, “NEDAP e përgëzon Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për ndërmarrjen

e veprimit të shpejtë për të bërë që shumë banka shtetërore dhe ofrues të hipotekave të pranojnë një ndalim për 90 ditë të rimarrjeve për pronarët e shtëpive pas uraganit. Shpresojmë se të gjithë huadhënësit që bëjnë biznes në shtet do të ndjekin këto masat, të cilat janë urgjentisht të nevojshme për të parandaluar një valë tjetër të gjendjes së vështirë të hipotekave dhe rimarrjeve në komunitetet e Nju Jorkut të goditura nga stuhia."

Kirstën Kifi (Kirsten Keefe), Avokate e Lartë, Empire Justice Center, tha, "Përshëndesim reagimin e shpejtë të Guvernatorit Kuomo (Cuomo) dhe besojmë se do të jetë një ndihmë e mirëpritur për shumë pronarë të shtëpive të prekur nga Sendi (Sandy). Kur dikush pëson dëm të shtëpisë së tyre ose humbet të ardhura për shkak të një katastrofe natyrore si Sendi (Sandy), shfaqen gjëra të reja të nevojshme të jetës dhe njerëzit thjesht kanë nevojë për një ndalim të detyrimeve të rregullta financiare të tyre. Shpresojmë se ndalimi prej tre muajsh dhe zgjatja e kohës për pagesat që po jepen nga bankat do të jetë kohë e mjaftueshme që shumica e njerëzve të ngrihen përsëri në këmbë. Gjithashtu shpresojmë se ky është një hap i parë dhe se huadhënësit do të vazhdojnë të punojnë përtej ndalimit me pronarët e shtëpive të prekur më rëndë, të cilët pësuan dëm më të madh ose humbje të plotë të shtëpive të tyre."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418